



Prishtinë, 13 prill 2017  
Kodi i ZRRE: V\_907\_2017

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,**

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 Nenit 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të transmetimit dhe tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT-së);
- Vendimi nr. V\_518\_2013 për Të Hyrat Maksimale Të Lejuara (MAR) për periudhë rregullative shumë vjeçare që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Tregut SHA (KOSTT SH.A.);
- Aplikacionin e KOSTT SH.A., për të hyrat e Lejuara në kuadër të Shqyrtimit Njëmbëdhjetë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE11), të dorëzuar me datën 23 janar 2017,

në seancën e mbajtur më 31 mars 2017 nxori këtë:

**V E N D I M**

- I. APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (MAR) që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut (KOSTT SH.A.) përmes tarifave për vitin relevant tarifor (SHTE11) duke filluar nga data 1 prill 2017.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga OST/OT për vitin relevant rregullativ tarifor (SHTE11) janë përcaktuar në shumë prej **25,221,595** euro.
- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës për Të Hyrat e OST/OT-së.
- IV. Të Licencuarit për OST/OT duhet t'i përgatisin dhe dorëzojnë për aprovim ZRRE-së tarifat për operim të sistemit të transmetimit operatorit të tregut të përcaktuar në MAR-in këtij vendimi para vitit relevant tarifor.
- V. Tarifat e propozuara nga OST/OT duhet të jenë në përputhje me Metodologjinë e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit të Transmisionit (TNUOS), Metodologjinë e Ngarkesave të Operatorit të Sistemit dhe Metodologjinë e Ngarkesave të Operatorit të Tregut të aprovuara nga ZRRE .





## ARSYETIM

- Rregullatori me datë 23 janar 2017 nga KOSTT SH.A. ka pranuar aplikacionin për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale që duhet mbledhur përmes tarifave të rreguluara për aktivitetet e OST/OT.
- Rregullatori për përcaktimin e të Hyrave të lejuara maksimale ka marrë parasysh dokumentet nxjerra dhe të publikuara në faqen zyrtare të saj:
- Vlerësimi përfundimtar i Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës (KOSTT sh.a.), i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
  - Vlerësimi përfundimtar- Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
  - Raportin Konsultativ- Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT), i publikuar me datën 28 shkurt 2017;
  - Raport përfundimtar për të hyrat e lejuara Maksimale të OS/OT për SHTE11;
- VI. Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranura nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- VII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të zbatohet nga KOSTT SH.A. duke filluar nga data 1 prill 2017 dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Krenar Bujupi, u.d kryesues

  
Arsim Janova, anëtar, anëtar,

  
Besim Sejfiqaj, anëtar.

**Vendimi iu dërgohet:**

Palës,dhe  
Arkivit të ZRRE-së.